



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA



Kryetari i Komunës

01-Nr. 016-25/118

Me datë: 02-06-2026

Ne bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe 2, lidhur me nenin 4 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluejtshme Ligji Nr. 03/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.52/2009), me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 të datës 10 dhjetor 2010; nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016); bazuar në Vendimin me nr. Prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025 për shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës së subjektit kërkuar të Drejtorisë për Bujqësi Zhvillimit Rural dhe Pylltari; bazuar në Vendimin Preliminar mbi ligjëshmerinë e shpronësimit të paluejtshmerisë me nr. prot. 01-Nr-464-10638 datë 04.03.2026, për "ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqanë", Kryetari i Komunës së Suharekës, brenda afatit ligjor, merr këtë :

VENDIM PËRFUNDIMTAR

I. SHPRONESOHET prona private e pronarëve dhe zotruesve të interesit, për interes publik dhe për „Ndërtimin e rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqanë”, e cila gjendet në pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116043-01122-0, në sip. prej 95m² me kultur Arë e Klasës 1, dhe pjesën e parcelës kadastrale me nr. P-72116043-01101-2, në sip. prej 78m² me kultur Arë e Klasës 1 në vendin e quajtur "RUPE/DRUM" e cila evidentohet sipas qertifikatës së pronës në emër të Durak Ali Berishaj ZK. Sopijë.

II. VERTETOHET se ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës publike në Zonën Kadastrale Sopijë, është qëllim i ligjshëm dhe interes publik dhe se shpronësimi i palujtshmerisë së lartëcekur do të shërbej për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe është në shërbim të arritjes së këtij qëllimi.

III. Pjesë integrale e këtij vendimi është raporti i vlerësimit i pranuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluejtshme /Ministria e Financave , Punës dhe Transfereve. Pronarët e palujtshmerisë për pronën e shpronësuar të evidentuar si në pikën 1 të këtij Vendimi, kompenzohen konform Aktit-vlerësimit të pranuar si në tabelën e bashkangjitur në shumën prej:

- Për parcelën kadastrale me nr. P-72116043-01122-0, në sip. prej 95m² 15.00€/m² (pesëmbëdhjet euro.€), ndërsa për pronën e përgjithshme të shpronësuar në sip. prej: 95m², kompenzohet në shumën totale prej: 1,425.00 €. (njëmij e katërqin e njëzet e pesë euro.€).

- Për parcelën kadastrale me nr. P-72116043-01101-2, në sip. prej 78m² 20.00€/ m² (njëzet euro.€), ndërsa për pronën e përgjithshme të shpronësuar në sip. prej: 78m², kompenzohet në shumën totale prej: 1,560.00 €. (njëmij e pesëqin e gjashtëdhjet euro.€).

IV Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, të Vendimit Përfundimtar , Organi shpronësues, këtë Vendim ia dërgon subjektit kërkuar dhe personave të tjerë të cilët duhet të identifikohen në Vendimin Përfundimtar.

V. Në përputhje me nenin 11 paragrafi 8, nenin 12 dhe nenit 16 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluejtshme Ligji Nr. 03/L-139, pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi Përfundimtar, dhe pas pagesës së kompenzimit të përcaktuar me këtë vendim, si dhe pas plotësimit të kushteve të parapara me ligj ,



Drejtoria Për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër në Komunën e Suharekës merr të gjitha veprimet për regjistrimin e pronës në emër të PSH Komuna e Suharekës.

VI. Vendimi Përfundimtar hynë në fuqi datën e shpalljes në një Gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

A r s y e t i m

Subjekti kërkues-Drejtoria për Bujqësi Zhvillimit Rural dhe Pylltari në Komunën e Suharekës, me kërkesën nr. 01-052-69255 të datës 05.11.2025 ka kërkuar nga Kryetari i Komunës së Suharekës iniciimin e procedurës administrative për shpronësimin e paluajtëshmërive për interes publik dhe për realizimin e projektit për **“ndërtimi i rrugës që lidhë fshatrat Shirokë – Sopijë – Topliqanë”**, si në dispozitiv të këtijë Vendimi.

Subjekti kërkues, kësaj kërkesë ia ka bashkangjitur dokumentacionin e nevojshëm i cili parashihet me dispozitat e nenit 8. lidhur me nenin 4. të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Organi shpronësues pas shqyrtimit të kërkesës ka ardh në përfundim se shpronësimi i palujtshmerisë të evidentuar në dispozitiv të këtij Vendimi është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtit qëllim, dhe se shpronësimi në fjalë prek të drejtën private, se pjesa e pronës së palujtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues dhe se Organi shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluejtshme.

Organi shpronësues- Kryetari i Komunës ka miraturar kërkesën e subjektit kërkues për shpronësimin e pronës së paluejtshme për interes publik me Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim me nr. Prot. 01-Nr-036-71006 të datës 18.11.2025

Po ashtu në afatin ligjorë, organi shpronësues ka miraturar Vendimin Preliminar për ligjshmërin e shpronësimit të propozuar me nr. prot. 01-Nr-464-10638 datë 04.03.2026

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për iniciimin dhe zhvillimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa e subjektit kërkues për shpronësimin është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtën e paraqitjës së ankesës për kundërshtimin e tij, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej 30 ditëve kalendarike pas datës së hyrjes në fuqi të këtijë Vendimi. Në të njejtën ditë në të cilën parashtruesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtëpërdrejt të dorëzojë në Zyrën Ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për Shpronësim).

Vendimi u dërgohet:

Subjektit kërkues

Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe

Arkivit

Kryetari i Komunës
Bali Mubharremaj

pën. 

